



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave



REPUBLIKA E KOSOVËS
Kaçanik, 20.12.2022
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data 20.12.22	Vendi KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë
07	104/02-33352	1

Raporti

Konsultimi Publik për Draft-Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në komuna me theks neni 5. Zbatimi i standardeve të konsultimit publik dhe neni 17 Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

Takimet

Me të përfunduar Draft dokumenti për Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave nga grupi punues, i është përcjellë zyrës së informimit për publikim dhe në të njëjtën kohë është publikuar edhe njoftimi për mbajtjen e Konsultimit Publik.

Publikimi në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe Platformën e Konsultimeve Publike

-Me 05. 12.2022, është publikuar njoftimi për mbajtjen e konsultimit për : Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave. Njoftimi është publikuar në uebfaqen zyrtare të komunës, facebook-un e komunës dhe Platformën e Konsultimeve Publike.

Publikimi në uebfaqe: Njoftimi dhe draft dokumenti:

<https://kk.rks-gov.net/kacanik/wp-content/uploads/sites/14/2022/12/per-fatl.pdf>

<https://kk.rks-gov.net/kacanik/category/konkurset-njoftimet/draft-dokumente/>

Publikimi në Platformën e Konsultimeve Publike:

<https://konsultimet.rks-gov.net/consultations.php?InstitutionID=20512&OpenPage=0&ClosedPage=0>

Rikujtimi i publikuar në facebookun e komunës:

<https://www.facebook.com/KomunaKacanik>

19.12.2022

Debat me qytetarë, administratorë dhe zyrtar komunal:

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal

Ora 13:00

Komentet:

Ibrahim Dalloshi- Përfaqësues i Lokalitetit Doganaj

Kam mëdyshje tek klasifikimi i mbeturinave, vlerësimi në peshë, mund të ketë ndikim tek pagesa, sepse shumë qytetar duke u munduar që të bëjnë më pak kilogram mund edhe ti hedhin mbeturinat vend e pa vend e të mos i fusin në kontejner.

Fadil Vishi- Përfaqësues i Lokalitetit Dubravë

Jemi të kënaqur me shërbimin e mbledhjes së mbeturinave dhe makinerinë që përdoret. Por kam dyshimet e mia edhe unë sa i përket asaj që më vonë të paguhet sasia e mbeturinave e jo pagesa fikse. Kjo për arsye se shumë qytetar mund ti ikin pagesës, duke deklaruar më pak kg se sa në realitet kanë.

Përgjigjet:

Pas mbledhjes së komenteve, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë së bashku me gjithë stafin ka diskutuar dhe ka dhënë këto përgjigje:

**Përgjigje: Ibrahim Dalloshit- Përfaqësues i Lokalitetit Doganaj dhe
Fadil Vishi- Përfaqësues i Lokalitetit Dubravë**

- Futja e tarifës volumerike inkurajon gjeneruesin e mbeturinës që të bëjë ndarjen në burim ngase do të paguaj vetëm për peshën që ka në kontenjerë familjar kurse mbeturinën e ndarë mund ta kompostoj (nëse është organike) apo ta deponoi mbeturinën (leter-qelq-metal) dhe të përfitoi nga kompania e kontraktuar për grumbullimin e kësaj kategorie të mbeturinave.

Raporti u përpilua nga DSHPE.



Enver Nadush Osmani

Drejtore i DSHPE-së